

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN "PËR KONTRIBUTIN KOMBËTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË BUXHETIN E BASHKIMIT EVROPIAN"

I. QËLLIMI I PROJEKTVENDIMIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji "Për kontributin kombëtar të Republikës së Shqipërisë në buxhetin e Bashkimit Evropian" synon krijimin e kuadrit të nevojshëm ligjor dhe institucional për organizimin, koordinimin dhe administrimin e procesit të përlllogaritjes, planifikimit, financimit, raportimit dhe vënies në dispozicion të kontributit kombëtar të Republikës së Shqipërisë në buxhetin e Bashkimit Evropian, në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Projektligji krijon bazën ligjore për ngritjen dhe funksionimin e mekanizmave kombëtarë që garantojnë përgatitjen e institucioneve shtetërore për zbatimin e *acquis communautaire* në fushën e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian (Oën Resources), duke siguruar që, në momentin e anëtarësimit, Republika e Shqipërisë të disponojë strukturat administrative, procedurat, sistemet e informacionit dhe mekanizmat e koordinimit të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Qëllimi i projektligjit nuk kufizohet vetëm në rregullimin e procedurave për planifikimin dhe vënien në dispozicion të kontributit kombëtar, por synon gjithashtu krijimin e një sistemi të unifikuar kombëtar për administrimin e të dhënave që shërbejnë për përlllogaritjen e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian, duke garantuar cilësinë, saktësinë, gjurmueshmërinë, dokumentimin dhe verifikueshmërinë e tyre, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

Projektligji mbështetet në parimin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitutional, pa cenuar kompetencat funksionale të institucioneve përgjegjëse të përcaktuara nga legjislacioni sektorial. Çdo institucion vijon të ushtrojë kompetencat e tij ligjore në fushën përkatëse, ndërsa projektligji përcakton mekanizmat e koordinimit, shkëmbimit të informacionit dhe raportimit të nevojshëm për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga sistemi i Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian.

Gjithashtu, projektligji synon të sigurojë përgatitjen e administratës publike shqiptare për zbatimin efektiv të detyrimeve që burojnë nga Kapitulli 33

"Dispozitat financiare dhe buxhetore", duke krijuar një kuadër të qëndrueshëm institucional dhe proceduror, i cili garanton përputhshmërinë me standardet e Bashkimit Evropian dhe kontribuon në minimizimin e rrezikut të korigjimeve financiare, penaliteteve apo interesave të vonësës që mund të lindin nga mospërbushja e detyrimeve për administrimin, raportimin dhe vënien në dispozicion të Burimeve të Veta.

II. VLERËSIMI I PROJEKT-AKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në Programin Analitik të Projektakteve të Këshillit të Ministrave për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTVENDIMIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Nevoja për hartimin e këtij projektligji buron nga detyrimet që rrjedhin nga procesi i anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, në veçanti nga kërkesat e Kapitullit 33 "Dispozitat financiare dhe buxhetore", i cili parashikon krijimin e një sistemi kombëtar të aftë për administrimin, përllogaritjen, raportimin dhe vënien në dispozicion të Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian.

Kuadri ligjor aktual rregullon veçmas funksionet dhe kompetencat e institucioneve përgjegjëse në fushën e administrimit doganor, administrimit tatimor, statistikave zyrtare, mbrojtjes së mjedisit dhe menaxhimit të financave publike. Megjithatë, mungon një kuadër ligjor horizontal që të përcaktojë mekanizmat e koordinimit ndërinstitutional, përgjegjësitë për administrimin dhe shkëmbimin e të dhënave, si dhe procedurat për përllogaritjen, planifikimin, raportimin dhe administrimin e kontributit kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian.

Në mungesë të një kuadri të tillë, ekziston rreziku që proceset e administrimit të të dhënave të zhvillohen në mënyrë të fragmentuar, duke vështirësuar koordinimin ndërinstitutional, unifikimin e metodologjive, garantimin e cilësisë dhe gjurmueshmërisë së të dhënave, si dhe përmbushjen në kohë të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.

Për këtë arsye, projektligji krijon bazën ligjore për organizimin e mekanizmave të koordinimit ndërinstitutional, përcakton përgjegjësitë e institucioneve publike sipas fushave të tyre të kompetencës dhe vendos rregulla për administrimin, shkëmbimin, dokumentimin, kontrollin dhe raportimin e të dhënave që përdoren për përlogaritjen e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian. Njëkohësisht, ai përcakton Ministrinë përgjegjëse për financat si autoritetin koordinues të procesit, pa cenuar kompetencat funksionale të institucioneve të tjera përgjegjëse.

Një nga përparësitë kryesore të projektligjit është krijimi i një kuadri të qartë institucional, në të cilin përgjegjësitë e secilit institucion përcaktohen në mënyrë të qartë, duke shmangur mbivendosjen e kompetencave dhe duke garantuar bashkëpunimin efektiv ndërinstitutional. Projektligji krijon gjithashtu bazën ligjore për administrimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave, i cili siguron integritetin, saktësinë, gjurmueshmërinë dhe dokumentimin e informacionit që përdoret për përlogaritjen e kontributit kombëtar.

Një përparësi tjetër e projektligjit është krijimi i mekanizmave që mundësojnë planifikimin në kohë të detyrimeve financiare që do të lindin pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, duke forcuar lidhjen ndërmjet administrimit të Burimeve të Veta dhe procesit të planifikimit buxhetor.

Miratimi i projektligjit pritet të ketë ndikim pozitiv në forcimin e kapaciteteve institucionale të administratës publike, në përmirësimin e koordinimit ndërinstitutional, në rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së të dhënave zyrtare, si dhe në garantimin e përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i Bashkimit Evropian në fushën e Burimeve të Veta.

Gjithashtu, projektligji pritet të kontribuojë në minimizimin e rrezikut të korrigjimeve financiare, penaliteteve ose interesave të vonësës që mund të lindin nga mosrespektimi i kërkesave të Bashkimit Evropian lidhur me administrimin, raportimin dhe vënien në dispozicion të Burimeve të Veta, duke rritur njëkohësisht besueshmërinë e institucioneve shqiptare në procesin e negociatave dhe pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUESHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është hartuar në mbështetje të nenit 78 dhe 83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKT-AKTET NORMATIVE)

Projektligji është hartuar në përputhje me *acquis communautaire* në fushën e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian (Oën Resources) dhe synon krijimin e kuadrit ligjor dhe institucional të nevojshëm për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni i Bashkimit Evropian pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Projektligji përafron legjislacionin kombëtar me aktet e Bashkimit Evropian që rregullojnë sistemin e Burimeve të Veta, duke reflektuar kërkesat për organizimin institucional, koordinimin ndërinstitutional, administrimin, raportimin dhe kontrollin e të dhënave që përdoren për përllogaritjen dhe vënien në dispozicion të kontributit kombëtar.

Shkalla e përafrimit me *acquis communautaire* dhe aktet konkrete të Bashkimit Evropian që përafrohen me këtë projektligj pasqyrohen në mënyrë të detajuar në Tabelën e Përputhshmërisë, e cila shoqëron projektligjin.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji përbëhet nga 22 nene të organizuara në shtatë krerë dhe përcakton kuadrin ligjor, institucional dhe procedural për administrimin e Kontributit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë në buxhetin e Bashkimit Evropian, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian për Burimet e Veta

Kreu I – Dispozita të Përgjithshme përcakton objektin, qëllimin dhe fushën e zbatimit të projektligjit, si dhe përkufizimet e termave kryesorë të përdorur në të. Ky kre vendos bazën konceptuale dhe terminologjike mbi të cilën mbështetet zbatimi i ligjit, duke përcaktuar kategoritë e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian dhe konceptet kryesore që lidhen me administrimin e Kontributit Kombëtar, në përputhje me terminologjinë dhe parimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian.

Kreu II – Korniza Institucionale rregullon organizimin institucional për administrimin e Kontributit Kombëtar, duke përcaktuar institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre. Në këtë kre parashikohen roli dhe funksionet e Komitetit Kombëtar për Kontributin Kombëtar në Bashkimin Evropian, ministrisë përgjegjëse për financat si Autoritet Kombëtar Koordinues, si dhe përgjegjësitë e institucioneve të tjera publike për administrimin, përpunimin, raportimin dhe kontrollin e të dhënave që përdoren për përllogaritjen e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian.

Kreu III – Procedura e Planifikimit, Llogaritjes, Certifikimit, Raportimit dhe Vënies në Dispozicion të Kontributit Kombëtar në Buxhetin e Bashkimit Evropian rregullon procedurat që lidhen me planifikimin buxhetor, përllogaritjen, certifikimin, raportimin dhe vënien në dispozicion të Kontributit Kombëtar. Gjithashtu, ky kre përcakton procedurat për rishikimin dhe korrigjimin e të dhënave dhe të kontributit, në përputhje me kërkesat dhe afatet e përcaktuara në legjislacionin e Bashkimit Evropian, duke garantuar administrimin e saktë dhe në kohë të detyrimeve financiare.

Kreu IV – Mbledhja dhe Shkëmbimi i të Dhënave përcakton rregullat për administrimin e Bazës Kombëtare të të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian, si dhe procedurat për mbledhjen, përpunimin, shkëmbimin, ruajtjen dhe dokumentimin e të dhënave ndërmjet institucioneve përgjegjëse. Ky kre rregullon gjithashtu periodicitetin e raportimit, standardet e cilësisë së të dhënave dhe mekanizmat e bashkëpunimit ndërinstitucional, me qëllim garantimin e integritetit, saktësisë dhe gjurmueshmërisë së informacionit që përdoret për përllogaritjen e Kontributit Kombëtar.

Kreu V – Auditimi, Kontrolli i Jashtëm dhe Verifikimi Ndërkombëtar përcakton mekanizmat për auditimin, kontrollin dhe verifikimin e të dhënave dhe procedurave që lidhen me administrimin e Burimeve të Veta të Bashkimit Evropian. Gjithashtu, ky kre rregullon bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kombëtare dhe organeve kompetente të Bashkimit Evropian gjatë proceseve të auditimit dhe verifikimit, me qëllim garantimin e përputhshmërisë së plotë me kërkesat e *acquis communautaire* dhe sigurimin e besueshmërisë së të dhënave të raportuara.

Kreu VI – Përgjegjësia për Shkeljet rregullon përgjegjësinë për moszbatimin e detyrimeve të parashikuara në projektligj, duke përcaktuar rastet e shkeljeve dhe

pasoja që rrjedhin prej tyre. Ky kre parashikon se personat përgjegjës mbajnë përgjegjësi administrative, disiplinore, civile ose penale, sipas legjislacionit në fuqi, duke synuar garantimin e zbatimit efektiv të ligjit dhe forcimin e llogaridhënies institucionale.

Kreu VII – Dispozita të Fundit dhe Kalimtare përmban dispozitat që lidhen me nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme për zbatimin e ligjit, përcaktimin e afateve për miratimin e tyre, si dhe hyrjen në fuqi të ligjit. Gjithashtu, ky kre rregullon momentin e fillimit të zbatimit të dispozitave që lidhen me administrimin dhe vënien në dispozicion të Kontributit Kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian, duke e lidhur atë me momentin e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

VII.INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ AKTI

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohen Ministria përgjegjëse për financat, INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Ministria përgjegjëse për mjedisin.

VIII.PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKT-AKTIT

Projektligji është hartuar nën koordinimin e ministrisë përgjegjëse për financat, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse që kanë rol në administrimin dhe sigurimin e të dhënave të nevojshme për përlogaritjen dhe administrimin e Kontributit Kombëtar të Republikës së Shqipërisë në buxhetin e Bashkimit Evropian, përkatësisht Institutin e Statistikave (INSTAT), Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe ministrinë përgjegjëse për mjedisin.

Në procesin e hartimit të projektligjit janë marrë në konsideratë kërkesat e legjislacionit të Bashkimit Evropian për Burimet e Veta, detyrimet që lidhen me Kapitullin 33 të acquis të Bashkimit Evropian, si dhe nevoja për përcaktimin e një kuadri institucional dhe procedural që mundëson përgatitjen graduale të administratës shqiptare për përmbushjen e këtyre detyrimeve. Projektligji do të dërgohet për mendim tek ministritë e linjës.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Miratimi i këtij projektligji nuk parashikon efekte financiare të drejtpërdrejta në buxhetin e shtetit gjatë periudhës para anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, pasi detyrimet financiare që lidhen me vënien në dispozicion të Kontributit Kombëtar në buxhetin e Bashkimit Evropian lindin nga data e anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Efekti financiar i projektligjit në periudhën para anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian lidhet kryesisht me forcimin e kapaciteteve institucionale, harmonizimin metodologjik me acquis të Bashkimit Evropian, si dhe zhvillimin e proceseve të koordinimit dhe raportimit ndërinstitucional.

Detyrat dhe përgjegjësitë shtesë që rrjedhin nga zbatimi i këtij projektligji për Ministrinë përgjegjëse për Financat, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, Institutin e Statistikave (INSTAT) dhe Ministrinë përgjegjëse për Mjedisin, parashikohet të përballohen brenda fondeve buxhetore ekzistuese të alokuara për këto institucione, në përputhje me strukturat dhe kapacitetet e tyre aktuale.

Sa i përket investimeve të nevojshme për krijimin dhe mirëmbajtjen e Bazës Kombëtare të të Dhënave për Burimet e Veta të Bashkimit Evropian, si dhe për përshtatjen ose zhvillimin e sistemeve informatike të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit, vlerësimi i kostove përkatëse do të kryhet në fazat e mëvonshme të zbatimit. Këto nevoja do të planifikohen dhe financohen në përputhje me procedurat dhe kërkesat e legjislacionit buxhetor në fuqi, në kuadër të planifikimit buxhetor afatmesëm.

Për më tepër, parashikojmë që një pjesë e nevojave për ngritjen e kapaciteteve, asistencën teknike, zhvillimin e sistemeve të informacionit dhe harmonizimin me standardet e Bashkimit Evropian do të mbështetet përmes fondeve të asistencës së para-anëtarësimit dhe instrumenteve të tjera mbështetëse të Bashkimit Evropian, sipas programeve dhe mekanizmave përkatës të financimit.

Pas anëtarësimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zbatimi i këtij ligji do të sjellë efekte financiare që lidhen me detyrimin e Republikës së Shqipërisë për të kontribuar në buxhetin e Bashkimit Evropian nëpërmjet

Burimeve të Veta, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian dhe kuadrin financiar përkatës.

MINISTRI

Petrit Malaj